



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 2030/Prot.
(Lutemi referojuni në rast përgjigje)

Tiranë, më 15. 5. 2023

NJOFTIM

PËR VEND PUNE

SPECIALIST I SEKTORIT TË NJOHJES SË DIPLOMAVE TË ARSIMIT TË LARTE, I PAJISJES SE IAL ME REGJISTRA DHE I REGJISTRIMIT TË FORMAVE TE DIPLOMAVE, NË QENDREN E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr., 1013, datë 10.12.2010, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", i ndryshuar dhe të Urdhrit të Kryeministrit nr.146, datë 28.09.2018, "Për miratimin e strukturës dhe të organizatës së Agjencisë Kombëtare të Provimeve", i ndryshuar, Qendra e Shërbimeve Arsimore njofton shpalljen e vendit të lirë të punës:

1. Në pozicionin e Specialistit të Sektorit të Njohjes së Diplomave të Arsimit të Lartë, i Pajisjes se IAL me Regjistra dhe i Regjistrimit të Formave të Diplomave të Drejtorinë e Shërbimeve Arsimore, në QSHA. Përgjegjësi i Sektorit punon nën drejtimin e Drejtorit të Drejtorisë dhe Drejtorit të QSHA-së, ndihmon në orientimin e punës që ka si qëllim organizimin, përpilimin e planeve, sigurimin e kryerjes së detyrave, lehtësimin e qarkullimit të informacioneve, si dhe siguron një bashkëpunim të mirë me kolegët e punës dhe grupet e ndryshme që mund të ndihmojnë në kryerjen e detyrave të sektorit. Në këtë kuadër përfshihet një game e gjerë detyrash që mund të lindin edhe gjatë zhvillimit të sektorit.

2. Kualifikimet, aftësitë dhe eksperiencia që kërkohet për këtë vend pune janë:

- ✓ Diplomë universitare,
- ✓ Të punojë vazhdimisht për zgjerimin e njohurive shkencore, profesionale dhe menaxheriale në mënyrë të dokumentuar;
- ✓ Njohja e mirë e legjislacionit arsimor dhe politikave arsimore dhe të strategjive të zbatimit të këtyre politikave .
- ✓ Aftësi për analizën e të dhënave cilësore ose sasore, shkrimit akademik.
- ✓ Aftësi e të dëgjuarit, shkrimit dhe të folurit në mënyrë efektive.
- ✓ Të ketë njohuri dhe aftësi të mira për komunikim në gjuhën angleze.
- ✓ Aftësi në Përdorimin e Kompjuterit;
- ✓ Aftësi në përdorimin në mënyrë efektive të dhënave informatike.
- ✓ Aftësi të mira nder personale, për të punuar në ekip dhe të marrë iniciativë.
- ✓ Aftësi për të punuar nën presion dhe me afate të ngushta.
- ✓ Aftësi të ndjekë dhe menaxhojë disa detyra në të njëjtën kohë.
- ✓ Përkushtim ndaj misionit dhe qëllimeve të Qendrës së Shërbimeve Arsimore.
- ✓ Paga për pozicionin është në kategorinë IV-a.

3. Paraqitja e dokumenteve: Kandidati duhet të paraqesë brenda datës 19.05.2023 në sekretarinë e Qendrës së Shërbimeve Arsimore, me adresë, QSHA, Bulevardi Zhan D'Ark nr. 23, Tiranë, Tel: +355 4 2419257, këto dokumente: Kërkesën për Aplikim, CV-në, fotokopje të notuar të diplomës dhe listës së notave, fotokopje të librezës së punës, fotokopje të certifikatave të kualifikimit, dëshmi të gjuhëve të huaja dhe të kompjuterit, vërtetimin e gjendjes gjyqësore, raportin mjekësor për aftësinë në punë, të paktën një letër rekomandimi, një numër telefoni për t'u kontaktuar, si dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.

Njoftimi për shpalljen e këtij vendi të lirë pune mund të gjendet edhe në faqen zyrtare të QSHA-së www.qsha.gov.al

Aurora BALLIU
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Bulevardi Zhan D'Ark Nr. 23, Tiranë

Web site: www.qsha.gov.al

Tel/fax. +355 4 2419257

E-mail: Aurora.Balliu@qsha.gov.al